



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.488/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesa e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e subjektit politik Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, Anr.488/2025, e datës 09.02.2025, të ushtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 09.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën me numër Anr.488/2025, nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendohet se më datë 08.02.2025 Sekretari i LVV në Lipjan — Valentin Amerllahu në rrjetin e tij social facebook shprehimisht thotë: *"Djali i kryetarit, Imri Ahmeti, del dhe lyp vota me makine 200 mije euro! Mas 9 shkurtit, keni me ja dorzu shtetit çdo cent qe keni vjedhur. Hajna klasik"*, me ç 'rast ka shkelur rënde nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të LZP-se. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si prove foto nga postimi në rrjetin social facebook. Me këtë rast ankuesi ka tentuar të dëmtoj reputacionin e kryetarit të Lipjanit Imri Ahmeti, duke ndjell gjuhe tipike urrejtëse, nxitëse e provokuese.

Në përgjigje në ankesë të datës 10.02.2025, subjekti politik LVV, thekson se në postimin me fotografi, z. Amërllahu ka njoftuar publikun për automjetin luksoz që shfrytëzohet nga familjari i kryetarit të komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, për të bërë fushatë për LDK-në. Z. Amërllahu ka ngritur gjithashtu pikëpyetje rreth pasurisë së pajustificueshme të familjarit të kryetarit, meqë vlera e automjetit të shfaqur në fotografi nuk përkon me të ardhurat e deklaruara publikisht nga z. Ahmeti si funksionar publik. Lëvizja VETËVENDOSJE! në programin e vet politik synon themelimin e një mekanizmi shtetëror për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së

pajustificueshme, në përputhje me kushtetutën e vendit dhe praktikat më të mira të shteteve demokratike evropiane. Duke paralajmëruar mundësinë e kthimit të pronës së pajustificueshme të shtetit, z. Amërllahu ka denoncuar një rast të mundshëm të pasurisë së pajustificueshme dhe ka paralajmëruar për pasojat.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Për faktin se pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i publikuar në rrjetin social i facebook të Sekretarit të LVV në Lipjan Valentin Amerllahu, duke i përdorur fjalët: *"Djali i kryetarit, Imri Ahmeti, del dhe lyp vota me makine 200 mijë euro! Mas 9 shkurtit, keni me ja dorëzuar shtetit çdo cent që keni vjedhur. Hajna klasik"*, nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe të urrejtjes në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore, fjalët e tilla nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon një person tjetër për të kryer një akt dhune kundër personave të tjerë ose pasurisë,


Andaj paneli vlerëson se deklarimi i lartcekur nga ana e Sekretarit të subjektit politik LVV, në Lipjan nuk konsiderohet se është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), e LZP-së, në të cilin nen përcaktohet se *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij) ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë."*

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *"vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr.488/2025, datë 11.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi